

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Magaznier, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse (Kategoria klasa IX).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhër Nr.414, datë 06.01.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e posaçme për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë ose dëftesë e arsimit të mesëm, *(për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësimi nga MAS)*;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe te huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Magaznieri ka për detyrë si më poshtë:

1. Mbajtja e fletëhyrjeve përkatëse, sipas gjendjes fizike, për të gjitha vlerat materiale që hyjnë në magazinë;
2. Administrimin, mirëmbajtjen e magazinës.
3. Mbajtja e urdhër dorëzimeve për daljen e të gjitha vlerave materiale nga magazina;
4. Kryerja e inventarizimit të vlerave materiale, jo më pak se një herë në vit, në fund të çdo viti ushtrimor me mbylljen e pasqyrave financiare;
5. Magaznieri është përgjegjës për humbjet, mungesat dhe prishjet e shkaktuara nga neglizhenca ose mos përmbushja me dashje e detyrave të caktuara në këtë rregullore;
6. Përmbush detyrat me profesionalizëm, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
7. Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët;

Dokumentat që aplikanti për Magazinier duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (ose dëftesë e arsimit të mesëm) dhe listë notash të noterizuara;
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Raport mjeko – ligjor;
7. Dëshmi penalteti;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 17.02.2023 ora 16.00